

UDHËZIM
Nr.12, datë 21.4.2009

PËR CAKTIMIN DHE PËRGATITJEN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, MËNYRËN E
NGRITJES SË GRUPEVE TË NUMËRIMIT DHE CAKTIMIN E TAVOLINAVE TË
NUMËRIMIT TË VOTAVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 93, nenit 94, nenit 95 dhe nenit 96 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për caktimin e vendndodhjes së vendit të numërimit të votave (VNV), përgatitjen e tyre, si dhe të rregullojë mënyrën e caktimit dhe të ngritjes së grupeve të numërimit (GN) dhe tavolinave të numërimit.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Vendndodhja e VNV-ve caktohet me vendim të KQZ-së, duke pasur për bazë kriteret e këtij udhëzimi.
2. Vendi i numërimit të votave caktohet, si rregull, në ndërtesa publike, si: pallat sporti, pallat kulture, qendër kulturore e fëmijëve, palestra sportive, salla kinemaje, ambiente të përshtatshme shkollash etj.
3. Vendi i numërimit të votave, me autorizim të veçantë të KQZ-së, mund të caktohet edhe në ndërtesa private nëse nuk është i mundur caktimi në ndërtesa publike.
4. Vendi i numërimit të votave nuk mund të caktohet në ndërtesa që përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike apo kandidati, ose të të afërmeve të tij.
5. KZAZ-ja organizon dhe përgatit vendin e numërimit të votave.

PJESA II
CAKTIMI I VENDNDODHJES SË VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE (VNV)

Neni 3
Vendndodhja e VNV-së

1. Vendndodhja e VNV-së caktohet me vendim të KQZ-së, jo më vonë se 30 ditë nga data e zgjedhjeve dhe vendoset menjëherë në dispozicion të KQZ-së për instalimin e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.
2. Në përcaktimin e vendit të numërimit të votave mund të përzgjidhet bashkia qendër rrethi, pavarësisht nëse ndodhet jashtë juridiksionit territorial të ZAZ-së, ose bashkisë brenda territorit të ZAZ-së, apo edhe në njësinë më të madhe administrative, nëse bashkitë nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 93 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 5 të këtij udhëzimi.
3. Në përzgjedhjen e VNV-së merren parasysh: përparësitë logjistike të transportit rrugor, distanca nga qendrat e votimit, hapësira që ofron salla, si dhe mundësia për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave.

Neni 4
Kritere teknike të VNV-së

Vendi i numërimit të votave, i përzgjedhur nga KQZ-ja, duhet të plotësojë të paktën kriteret e mëposhtme teknike:

- a) Për zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë në përbërje të tyre deri në 79 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 200 m².
- b) Për zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë në përbërje të tyre mbi 79 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 300 m².
- c) Të ketë sistem të siguruar e të pandërprerë ndriçimi dhe energji elektrike të mjaftueshme për të suportuar teknologjinë mbështetëse të numërimit të votave si në mjediset e brendshme, ashtu edhe përreth godinës.
- d) Të ofrojë mundësitë e instalimit të teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave.
- e) Të ketë, për aq sa është e mundur, më shumë se një derë komunikuese me mjedisin e jashtëm.
- f) Të jetë e pajisur me mjete të mbrojtjes kundër zjarrit, si dhe të ndihmës së shpejtë.

Neni 5

Organizimi i vendit të numërimit të votave

1. KZAZ-ja organizon dhe përgatit vendin e numërimit të votave, në mënyrë të tillë që të garantojë zhvillimin normal të punës për numërimin e votave.

2. KZAZ-ja organizon hapësirën e VNV-së, në mënyrë të tillë që të jetë e ndarë në mënyrë të qartë nga hapësira për vëzhguesit, kandidatët dhe mediat. Në asnjë rast nuk duhet cenuar mundësia e ndjekjes nga afër e procesit të numërimit dhe shfaqja e fletëve të votimit në monitorët e vendosur për këtë qëllim.

3. Organizimi fizik i hapësirës në dispozicion të çdo grupi numërimi duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të pengojë ndërhyrjen e personave të tjerë të pranishëm në VNV.

4. Menjëherë me marrjen në dorëzim nga KQZ-ja të VNV-së, KZAZ-ja, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, merr masa për krijimin e kushteve të përshtatshme për instalimin e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave. Jo më vonë se pesë ditë para ditës së zgjedhjeve, bëhet rregullimi përfundimtar i VNV-së, sipas planvendosjes orientuese bashkëlidhur këtij udhëzimi, si dhe vendosen pajisjet logjistike të nevojshme për kryerjen e procesit të numërimit, si më poshtë:

- a) Tavolina pune dhe 8 karrige për KZAZ-në;
- b) Tavinë pune me 2 karrige për ndihmësit teknikë;
- c) Dyshe tavolinash (vendosen sipas shpjegimit në skemën orientuese) me nga katër karrige për çdo tavolinë numërimi të votave;
- d) Kompjuter, printer, fotokopje dhe telefon/fax për KZAZ-në;
- e) Struktura ndarëse të hapësirës së publikut me hapësirën për numërimin e votave;
- ç) Tabelat treguese të dërguara nga KQZ-ja;
- f) Tabelat treguese për drejtimin e lëvizjes në mjediset e brendshme të VNV-së.

5. Në çdo rast, organi që administron objektin ku është vendosur VNV-ja, merr masa për sigurimin e pajisjeve logjistike të parashikuara në gerrat “a”, “b” dhe “c” të pikës 4 të këtij neni.

PJESA III

NGRITJA E GRUPEVE TË NUMËRIMIT

Neni 6

Caktimi i numrit të grupeve dhe tavolinave të numërimit

1. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë deri në 79 qendra votimi, KZAZ-ja cakton ngritjen e pesë tavolinave të numërimit dhe të dhjetë grupeve të numërimit.

2. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 80 deri në 100 qendra votimi, KZAZ-ja cakton ngritjen e gjashtë tavolinave të numërimit dhe të dymbëdhjetë grupeve të numërimit.

3. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 101 deri në 120 qendra votimi, KZAZ-ja cakton ngritjen e shtatë tavolinave të numërimit dhe të katërbëdhjetë grupeve të numërimit.

4. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 121 deri në 140 qendra votimi, KZAZ-ja cakton ngritjen e nëntë tavolinave të numërimit dhe të tetëmbëdhjetë grupeve të numërimit.

5. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë mbi 140 qendra votimi, KZAZ -ja cakton ngritjen e dhjetë tavolinave të numërimit dhe të njëzet grupeve të numërimit.

Neni 7
Grupet e numërimit të votave

1. Çdo KZAZ cakton me vendim ngritjen e grupeve të numërimit. Për caktimin e tyre, KZAZ-ja përdor modelin 05 V “Për caktimin e grupeve të numërimit të votave”, miratuar me vendimin nr.14, datë 23.2.2009 të KQZ-së “Për miratimin e modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit të punës së KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 28 qershor 2009”.

2. Grupet e numërimit të votave janë 2 për çdo tavolinë numërimi. GNV-të numërtohen me numër rendor rritës dhe përfundojnë gjithnjë me numër çift.

3. Një grup numërimi numëron jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10 qendra votimi.

4. Nëse është e nevojshme, grupet e dyta të numërimit të votave fillojnë punë sapo përfundojnë grupet e para të numërimit të votave.

5. Në çdo rast, grupet e dyta rrinë në gatishmëri dhe zëvendësojnë grupet e para me vendim të KZAZ-së, edhe nëse grupet e para ndërpresin punën për shkaqe të papërligjura.

6. Nëse nuk është e nevojshme, grupet e dyta nuk futen në punë.

7. Çdo grup numërimi përbëhet nga numëruesi i parë, sekretari dhe 2 anëtarë.

Neni 8
Emërimi i anëtarëve të grupeve të numërimit

1. KZAZ-ja, dhjetë ditë para ditës së zgjedhjeve, njofton me shkrim partitë politike të cilave u ka lindur e drejta të propozojnë anëtar të GNV-ve, për numrin e GNV-ve që do të ngrejë dhe i kërkon atyre të dorëzojnë propozimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, të paktën 4 ditë para ditës së zgjedhjeve.

2. Propozimet për dy nga anëtarët e grupeve të numërimit bëhen nga partitë politike, të cilat kanë kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-së, ndërsa propozimet për dy anëtarët e tjerë të GN-ve bëhen nga partitë politike të cilave u ka lindur e drejta të propozojnë anëtar të GN-ve sipas një akti të veçantë të KQZ-së.

3. KZAZ-ja, jo më vonë se dy ditë para datës së zgjedhjeve, emëron anëtarët e grupeve të numërimit pasi i gjen ato në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 11 dhe 12 të këtij udhëzimi.

4. Për emërimin e anëtarëve të GN-së, KZAZ-ja përdor modelin 06 V “Për emërimin e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave”, miratuar me vendimin nr.14, datë 23.2.2009 të KQZ-së “Për miratimin e modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit të punës së KZAZ-ve, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 28 qershor 2009”.

Neni 9
Procedura e shortit për numëruesin e parë dhe sekretarin e GNV-ve

KZAZ-ja emëron numëruesin e parë dhe sekretarin e grupeve të numërimit sipas procedurës së mëposhtme:

a) Partia politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “tek” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “çift” të numërimit të votave.

b) Partia politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “çift” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “tek” të numërimit të votave.

c) Anëtar i tretë dhe i katërt i grupeve të numërimit emërohen nga propozimet e partive politike, të cilave u ka lindur e drejta të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt, sipas shortit të hedhur në KQZ, për çdo ZAZ.

Neni 10
Paraqitja e propozimeve nga partitë politike

Propozimi për emrat e anëtarëve të GN-ve i paraqitet KZAZ-së. Partitë politike mund t’u delegojnë degëve lokale të tyre të drejtën e propozimit për anëtarë të GN-ve. Propozimet duhet, gjithnjë, të shoqërohen me dokumentet e mëposhtme:

a) Certifikatë personale me fotografi;

b) Kopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë.

Neni 11

Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të GNV-së

Anëtari dhe sekretari i grupit të numërimit të votave nuk mund të jetë:

- a) deputet ose kandidat për deputet në Kuvend;
- b) kryetar bashkie ose komune;
- c) ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose Shërbimit Informativ Shtetëror;
- d) anëtar apo sekretar të një grupi tjetër numërimi.

Neni 12

Kushtet për emërimin e anëtarit dhe I sekretarit të GNV-së

Anëtar dhe sekretar i grupit të numërimit të votave mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
- b) ka arsim të lartë;
- c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- e) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

Neni 13

Zëvendësimi i anëtarëve të grupit të numërimit

1. Në rast se një parti politike nuk paraqet propozim brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 95 pika 1 të Kodit Zgjedhor, KZAZ-ja me vendim cakton anëtarin zëvendësues.

2. Anëtari zëvendësues caktohet me short ndërmjet anëtarëve të KQV-ve që i përkasin këtij subjekti zgjedhor në zonën e administrimit zgjedhor.

3. Në rast se numri i anëtarëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 12 dhe në nenin 13 të këtij udhëzimi, brenda ZAZ-së, është më i vogël se numri i kërkuar për anëtarët e GNV-ve, KZAZ-ja i kërkon komisionit të administrimit zgjedhor më të afërt, që ndodhet në të njëjtën zonë zgjedhore, të sjellë listën e saj me anëtarët e QV-ve që plotësojnë këto kushte, të propozuara nga subjekti zgjedhor përkatës.

4. Procedura e shortit për anëtarët e GNV-ve, që zgjidhen nga një ZAZ tjetër, është e njëjtë.

5. Partia, e cila ka të drejtën të paraqesë propozimin për anëtarin e tretë ose të katërt të GNV-ve, sipas shortit të hedhur në KQZ dhe nuk ka përfaqësues në KQV, humbet të drejtën të paraqesë anëtar të GNV-ve nëse nuk respekton afatin e parashikuar në nenin 95 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

6. Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të grupit të numërimit të votave, ai funksionon me jo më pak se dy anëtarë.

Neni 14

Procedura e shortit për zëvendësimin e anëtarëve të GNV-ve

Procedura e shortit, e hedhur nga KZAZ-ja për anëtarin zëvendësues të GN-ve, është si më poshtë:

a) Sekretari i KZAZ-së për zgjedh të gjithë anëtarët e qendrave të votimit të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 12 dhe në nenin 13 të këtij udhëzimi.

b) Anëtarët e KQV-ve renditen, në mënyrë rastësore, në lista sipas partive politike të cilat i kanë propozuar.

c) Çdo emri, të renditur në secilën listë, i vendoset nga një numër rendor rritës, duke filluar nga 01.

d) Në një enë transparente, vendosen shirita letre ku janë shënuar numrat rendor që i korrespondojnë çdo anëtar i KQV-së së partisë përkatëse të renditur në listë.

e) Kryetari i KZAZ-së tërheq shirita letre në numër të barabartë me numrin e anëtarëve të GNV-ve që mungojnë.

f) Anëtari i KQV-së, i emëruar me propozim të partisë politike për të cilën hidhet shorti, caktohet anëtar i grupit të numërimit.

g) Në rast se partia politike, e cila nuk ka paraqitur propozime për anëtar të GNV-ve dhe nuk ka

anëtar në KQV i përket partive të shumicës parlamentare, shorti hidhet ndërmjet anëtarëve të KQV-së, që i përkasin partisë së dytë të shumicës parlamentare e cila ka propozuar anëtar në KQV.

h) Në rast se partia politike, e cila nuk ka paraqitur propozime për anëtar të GNV-ve dhe nuk ka anëtar në KQV i përket partive të opozitës parlamentare, shorti hidhet ndërmjet anëtarëve të KQV-së, që i përkasin partisë së dytë të opozitës parlamentare e cila ka propozuar anëtar në KQV.

Neni 15

1. Në rastet kur vendi i një anëtari të grupit të numërimit mbetet vakant gjatë procesit të numërimit të votave, partia politike e cila kishte propozuar anëtarin, paraqet menjëherë propozimin e ri.

2. Nëse partia politike nuk paraqet propozimin për plotësimin e vendit të mbetur bosh brenda 1 ore, KZAZ-ja zbaton procedurën e shortit sipas nenit 14 të këtij udhëzimi.

Neni 16

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ristani

Zgjedhjet për Kuvend të datës 28 Qershor 2009



LEGJENDA

EMERTIMI	NJESIA	SASIA
TAVOLINA PUNE	Cope	12
KARRIGE	Cope	60 (max)
SHIRIT NDARES	Meter	50 (max)
FAKS	Cope	1
TABELA SQARUESE	Cope	10
TEKNOLOGJI MBËSHTETËSE		

PLANVENDOSJE ORIENTUESE

E

VENDIT TE NUMERIMIT TE VOTAVE



